



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 44/12

Prishtinë, më 18.01.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj.

Mungoi: Naser Osmani.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza, Ministër i Financave, Alexander Beetz, Juergen Schatz, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami, nga GIZ, monitorues OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;
3. Shqyrtimi i kërkesën së Ministrisë së Punëve të Brendshme për lejimin e pagesë në paradhënie për blerjen e paisjeve për nevojat e Policisë së Kosovës, Të ftuar: Bajram Rexhepi, Ministër i Punëve të Brendshme; Bedri Hamza, Ministër i Financave
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
7. Shqyrtimi i Projekcionit të Buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-mars 2012. I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;
8. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për periudhën mars-dhjetor 2011;
9. Caktimi i grupit punues për Projektligjin nr.04/L-80 për Lojërat e Fatit;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi që rendin e ditës të plotësohet me një pikë të re e dhjetë me radhë: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për të cilin pikë jeni njoftuar edhe në formë elektronike se do të propozohet si pikë shtesë për shkak të kërkesë urgjente që projektligji të procedohet për miratim në seancë plenare.

Komisioni njëzëri miratoi plotësimin e rendit të ditës – pika dhjetë Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit

Albana Fetoshi, theksoi se ka vërejtje të procesverbalit i mbledhjes 15.12.2011, në diskutimin e saj fjalia nuk ka kuptim dhe kërkojë që të rregullohet. Ka edhe shumë qeshtje tjera që unë kam prituri të përfshihen në procesverbale, e që nuk janë lëshime më qëllim, por kërkojë që të jenë më të kujdesshëm

Procesverbalet miratohen me vërejtjet e deputetes Albana Fetoshi në procesverbalin dt. 15.01.2012.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme për lejimin e pagesë në paradhënie për blerjen e paisjeve për nevojat e Policisë së Kosovës,

Kryetarja, njoftoi kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka të bëjë me projekte kapitale dhe në bazë të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për 2012, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është kompetent për shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë lejimin e pagesë në paradhënie për investime kapitale, por vetëm për mallra dhe shërbime dhe si e tillë kërkesa nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në Kuvend.

Albana Fetoshi, pasi që kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka shumë pak informata dhe në mungesë të specifikimeve duke u thirrur se kemi të bëjmë me një marrëveshje konfidenciale nuk e kuptova se për qfarë mjete dhe qfarë shumë është fjala dhe do të ishte mirë që Ministri të na jap disa informacione për këtë çështje.

Bedri Hamza, theksoi se kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk është dashur fare të vie në Komisionin për Buxhet dhe Financa, pasi që sipas ligjit ky komision shqyrton kërkesat për lejimin e paradhënies vetëm për mallra dhe shërbime dhe jo për investime kapitale të cilat kërkesa duhet të drejtohen në Qeveri.

Pas sqarimeve, Komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni për Buxhet e Financa në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, nuk është kompetent për shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare

Kryetarja, theksoi se projektligji në fjalë rregullon infrastrukturën ligjore të institucioneve bankare, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, që parashifet licencimi mbikëqyrja e tyre dhe qeshtje të tjera që kanë të bëjnë me futjen në sistem të këtyre institucioneve, që të kemi një sistem financiar më të shëndoshë në përgjithësi. PL implikime buxhetore nuk ka dhe në është në harmoni me direktivat e bashkësisë evropiane dhe si i tillë është i përgaditur mirë edhe në aspektin përmbajtësor dhe teknik.

Bedri Hamza, theksoi se drafti i ligjit është harmonizuar me FMN dhe BB dhe është në përputhje të plotë me praktikën ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së, në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit të bankave dhe në përputhje me rregullat e Bazelit për mbikëqyrje bankare efektive. Drafti i ligjit ka për qëllim shfuqizimin e rregulloreve aktuale në fuqi dhe do të forcojë kornizën institucionale, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sektorit financiar. Projektligji përmirëson standardet e qeverisë dhe të bankave edhe përfshirë kufizimet për kreditimin e bankave dhe personave të lidhura me bankat. Dispozitat e këtij projektligji i japin autoritet Bankës Qendrore të ndërmerr masa përmirësuese dhe të vendosë gjëra administrative për shkeljet ligjore. Gjithashtu tani krijohet mundësia e vënies së bankës nën adresime zyrtare të pronësisë dhe në të njëjtën kohë eliminon paqartësinë ekzistuese në drejtim të institucioneve mikrofinanciare e jobankare.

Hykmete Bajrami, pyeti Ministrin sa a rregullohet në tërësi me këtë projektligj çështja e institucioneve mikrofinanciare dhe mundësia e kalimit të tyre në banka, pasi që transferimi i këtyre institucioneve në banka është një nga problemet kryesore. Këto institucione fillimisht janë regjistruar si OJQ dhe një prej kërkesave për të kaluar në institucione ka qenë që të paguhet tatimin në formë retroaktive duke ditur se kanë vepruar si organizata profitabile dhe kjo ka qenë një pengesë për BQK që të procedojë me kërkesat për transferimin e tyre në banka. Meqenëse këto institucione kanë ofruar kredi me norma interesi prej 20-30% dhe ndoshta kanë qenë institucionet më profitabile në këtë sektor, në këtë draft nuk kam gjetur prururazi si është rregulluar kjo çështje.

Bedri Hamza, projektligji rregullon në mënyrë detale çështjen e licencimit, vendosjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes për institucionet mikrofinanciare dhe këtë sektorë shumë të rëndësishëm. Megjithatë ligji nuk ka veprim retroaktiv, por që nga momenti i hyrjes në fuqi.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109

Kryetarja, theksoi se me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e kodit doganor dhe të akcizave janë bërë disa plotësime dhe ndryshime që kanë të bëjnë me procedurën e operatorëve të autorizuar ekonomike, procedurën e plotësimit të deklaratës përmbledhëse edhe vlerësimi i riskut dhe procedurës së ankesës dhe kundërvajtjes administrative. Për më tepër sqarime do të na ofrojë Ministri i Financave.

Bedri Hamza, njoftoi se me rastin e draftimit të projektligjit kanë pasur një bashkëpunim të ngushtë me drejtorin gjeneral të doganave dhe tatimit të Komisionit Evropian në Bruksel për përputhshmërinë e këtyre ndryshimeve me direktivat e BE-së. Ndryshimet dhe plotësimet kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë në pajtim me standardet me doganat evropiane. Po ashtu me këto ndryshime është propozuar për

uljen në minimum të kundërvajtjes doganore. Po ashtu përmes këtyre dyshimeve ne kemi future institutin e lëndëve të zgjedhure në mënyrë alternative, që do të jetë një fushë e favorshme për biznese për shkak të shkurtimit të kohës në zgjidhjen e kontesteve.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryetare, theksoi se projektligji ka të bëjë me ndryshimin e normës së tatimit në pronën e paluajtshme dhe si të tillë është i përgaditur mirë teknikisht.

Bedri Hamza, theksoi se qëllimi i ndryshimit të këtij ligji për tatimin në pronën e paluajtshme ka ardhur si rezultat që të krijohen parakushte që komunat të hyrat e tyre të bazojnë në një prej të hyrave me të qëndrueshme nga tatimi në pronë. Para ndryshimit të projektligjit, si Ministri kemi organizuar takime me kryetarët e komunave me të cilët jemi pajtuar për këto ndryshime. Për shkak të laramanisë në limitin e poshtëm të tatimit në pronë në komuna të ndryshme dhe pas konsultimeve që kemi pasur me FMN, kemi propozuar që limiti i poshtëm i tatimit në pronë të jetë 0.15% dhe është në kompetencë të komunës të vendos për rritjen e tij. Përveç kësaj me këto ndryshime dëshirojmë të rregullojmë procedurën e ankesave për tatimpaguesit që të kryejnë procedurat në përputhshmëri me ligjin. Në bisedat me FMN kanë rekomanduar që kufiri i poshtëm i tatimit në pronë të jetë 0.5%, pasi që edhe në vendet e zhvilluara ky lloj tatimi krijon të hyra të qëndrueshme dhe më të sigurta për komunat, mirëpo duke vlerësuar nivelin e zhvillimit ekonomik, kemi harmonizuar qëndrimet edhe me FMN që për këtë fazë limiti të jetë 0.15%, e që nuk do të jetë një ngarkesë e madhe edhe për gjendjen familjare.

Albana Fetoshi, pasi që me ndryshimin e ligjit është propozuar rritja e limitit të poshtëm të tatimit në 0.15%, pyeti Ministrin a mendon se është rritur shumë ky limit, kur dihet se më parë ka qenë më e ultë prej 0.07% deri 0.20%.

Bedri Hamza, deri më tani ka pasur dallime në limitet e poshtme të tatimit në komunat e ndryshme dhe kjo hapësirë ligjore është shfrytëzuar edhe për qëllime politike, ku disa kryetar të komunave në mënyrë të padrejte fushatë në emër të premtimeve për uljen e këtij tatimit. Tatimi është mjaftë i drejtë edhe ai që ka pasuri më të madhe paguan më shumë se qytetari me pasuri më të vogël.

Sali Asllanaj, përkrah iniciativën për ndryshimin e ligjit dhe vënien e standardit minimal për tatimin në pronë. Në këtë aspekt mendojë se për të mos lejuar që në emër të këtij tatimi të bëhet politikë për zgjedhje, do të kishte qenë mirë që të vendosej limiti 0.20% që do të ndikonte edhe në autonominë financiare të komunave dhe në gjenerimin më të madhë të të hyrave. Mundësia e rikthimit të grantit stimulues do të ketë ndikim pozitiv për inkasimin e të hyrave vetanake e më pak të varen nga buxheti qendror. Pyeti Ministrin a parashihen shkurtime buxhetore nga grandet qeveritare në të ardhmen si rezultat i ndryshimit të koeficientit për vitin 2013?

Hykmete Bajrami, theksoi se megjithë ndryshimin në kufirin e poshtëm, me këtë projektligj po iu lehet komunave që të përcaktojnë vetë kufirin e lartë. Shprehu mendimin se do të ishte mirë që të caktohej

edhe kufiri maksimal, pasi kjo mund të shfrytëzohet për qëllime politike në fushata zgjedhore dhe ka shumë qytetarët që ankohen se janë të diskriminuar në raport me fqinjët e tyre sa i përket tarifave të tatimit të pronë. Në këtë drejtim pyeti a ka ndonjë plan qeveria që në afatin më të gjatë të ndaj Kosovën në zona dhe kategori sa i përket kësaj qeshtje?

Bedri Hamza, theksoi se të gjitha të hyrat nga tatimi në pronë iu kthehen komunave si të hyra vetanake. Në pyetjen e z. Asllanaj theksoi se në vitin 2013 nuk do të ketë ndryshime në grandet për komunat. Mirëpo ka biseda dhe këshilla se grantet qeveritare janë të larta, por praktika tregon se komunat megjithë të hyrat vetanake kanë nevojë për mbështetje buxhetore pasi që mund të vie vështërsi funksionimin e tyre. Ndoshta kjo duhet të shifet në perspektiv. Sa i përket grantit stimulues ka qenë efektiv sepse i ka nxitur komunat ti mbledhin tatimet në shira më të mëdha dhe jemi duke punuar që të krijojmë një grati stimulues për komunat e suksesshme, që do të diskutohet në proceset e ardhshme buxhetore. Sa i përket ndarjes në zona është përgjegjësi ekskluzive e komunave.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme.

7. Shqyrtimi i Projektionit të Buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-mars 2012

Kryetarja, theksoi se pasiqë buxheti i RTK-së është në kuadër të buxhetit të Kuvendit, në kategorinë e subvencioneve, sikurse vitin e kaluar edhe këtë vit, do të duhej që ne si komision të shqyrtojmë projeksionet e buxhetit të RTK-së për vitin 2012 dhe në baza periodike dhe ti rekomandojmë për ekzekutimin e pagesave. Radiotelevizioni i Kosovës ka dërguar projeksionet për vitin 2012 dhe për periudhën janar-mars 2012 por në formë të përmbledhur. Për më tepër kërkoi nga drejtori gjeneral arsyetimin e kërkesës.

Sylejman Shaqiri, sa i përket projeksioneve të buxhetit të RTK-së ne jemi të kufizuar në mbulimin e aktiviteteve tona dhe do të kërkojmë në rishikim të buxhetit mjete shtesë. Ndërkaq nëse në ndërkohë Kuvendi miraton ligjin për RTK-në dhe më atë bëhet një zgjidhje edhe financiare do të ishte lehtësi e madhe për funksionimin e transmetuesit publik.

Hykmete Bajrami, nga raporti që keni dërguar për periudhën tetor-dhjetor 2011, shifet se RTK ka mbi shpenzim në kategorinë mallra dhe shërbime që nënkupton se jeni në obligime. Pyeti a keni arritur me i mbulue në vitin 2011 të gjitha obligimet apo janë bartur edhe këtë vit. Sa është vlera e këtyre obligimeve dhe qfarë efekti do të ketë ajo sepse do të kemi një përcjellje të borqeve prej viti në vit kur dihet se nuk keni pasurë ndonjë rritje të buxhetit si në vitin 2011.

Sylejman Shaqiri, në përgjigje e parafolësës, njoftoi se vitin e kaluar pas miratimit të buxhetit të Kosovës ne kemi marrur më pak mjete se sa vitin 2010, dhe ne kemi hyrë në obligime kontraktuese të natyrshme për punën e RTK-së dhe janë krijuar këto obligime. Ndërkaq që nga koha kur jam emëruar drejtuar drejtor 2009, kam trashëguar obligime afërsisht 2 milion € nga vitet paraprake, të cilat obligime janë zvogëluar gjatë vitit 2010 dhe 2011 dhe pas kalkulimeve vjetore në llogarinë përfundimtare, presim saktësisht të dijme sa kemi obligime.

Kryetarja, theksoi se në projeksionin e buxhetit të RTK-së nuk janë përfshirë të hyrat vetanake. Ndërsa çështja tjetër e rëndësishme janë obligimet që trashëgoni e që në projeksionet e juaja nuk shifet se do ti mbulonin këtë vit. Pyeti pse nuk pozicionet e juaja buxhetore nuk keni paraparë mbulimin e obligimeve nga vitet e kaluara që duhet paguhen këtë vit? Tejkalimi duket i madhë në krahasim me atë çka është planifikuar dhe do të duhej zgjidhur kjo çështje. Një çështje tjetër ka të bëjë më dërgimin me vonesë të projeksioneve për shqyrtim në Komision, sikurse ka ndodhur edhe vitin e kaluar dhe ju lutem ti dërgoni me kohë projeksionet që të kemi kohën e mjaftueshme për ti analizuar dhe për të dhënë rekomandimet tona.

Albana Fetoshi, theksoi se te pagat dhe mëditjet po shifet se po ka një diferencë dhe dëshirojë a është rritur numri i të punësuarve apo janë rritë mëditjet?

Muhamet Mustafa, me qenë se projeksionet e buxhetit duket shumë të mangëta, propozoi që në këtë mbledhje të mos rekomandojmë për ndarjen e buxhetit të RTK-së dhe ky medium të përgatit projeksionet në mënyrë më të specifikuar, duke bërë krahasime me vitin paraprak në pozicionet e caktuara, të tregojë të hyrat vetanake dhe të shihet niveli dhe mënyra e shpenzimeve dhe obligimet që janë krijuar.

Sali Asllanaj, megjithë vërejtjet dhe kërkesat e arsyeshëm që u ngritën, shfaqti mendimin që edhe kësaj here të rekomandohet aprovimi i buxhetit të RTK-së pasi që vonesat eventuale mund të kenë pasoja në punën e RTK-së dhe herave tjera të dërgohet projeksionet dhe raportet më të specifikuara

Kryetarja, theksoi se do të isha pajtuar me propozimin e z. Asllanaj për aprovimin e buxhetit të RTK-së, po të ndryshonte praktika e përmisimit në detalizimin e projeksioneve dhe raporteve periodike , përkundër kërkesës tonë që të bëhet një gjë e tillë vitin e kaluar. Prandaj si Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk do të ishte një punë e mirë nëse vendosim në këtë formë si na ka ardhur. Prandaj propozojë që të shtyhet miratimi i projeksioneve dhe RTK të na dërgojë një projeksion më të detalizuar të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore dhe më profesionale, duke bërë krahasime me vitin e kaluar për të parë rrjedhën e shpenzimeve, të hyrat vetanake dhe se si do të bëhet sistemimi i borqit në një afat sa më të shpejtë të jetë e mundur.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- I. Shtyhet miratimi i Projeksioneve të Buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 dhe periudhën janar-mars 2012 në një mbledhje tjetër të komisionit.
- II. Radiotelevizioni i Kosovës të përgatit projeksionin e detalizuar të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2012 dhe për periudhën janar-mars 2012, krahasimin e shpenzimeve me vitin paraprak dhe parashikimin e sistemimit të borqit brenda projeksioneve buxhetore.

8. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për periudhën mars-dhjetor 2011

Kryetarja, vlerësoi se jam befasuar për të mirë me punën e stafit në përgatitjen e një raporti gjithëpërfshirës dhe evidentimi e gjitha aktiviteteteve të komisionit. E kam shikuar raportin dhe i kam bërë disa plotësime që janë pasqyruar në raport.

Albana Fetoshi, sa i përket takimeve që i keni realizuar në cilësinë e kryetares së komisionit, që janë pasqyruar në raport, do të ishte mirë që pas atyre takimeve të raportoni në komision se qfarë është

biseduar në ato takim, sepse nuk më kujtohet që keni raportuar ndonjëherë në komision për këto takime. Nga informatat që kam një praktikë të këtillë raportimi e bëjnë kryetarët e komisioneve tjera

Kryetarja, në përgjigjen e parafolësës theksoi se për gjitha takimet e rëndësishme që ka mbajtur e ka njoftuar komisionin. Takimet që janë mbajtur kanë pasur të bëjnë çështjet që më vonë janë prezantuar dhe shqyrtuar në komision. Mua më vjen keq po më duket po krijoni përshtypje sikur nuk keni qenë në mbledhjet e Komisionit, sepse çdo çështje që ka qenë e rëndësishme është diskutuar në komision, si dhe për të gjitha vizitat është njoftuar komisioni.

Latif Gashi, theksoi se më kujtohet mua të gjithë anëtarët që kanë qenë prezent në mbledhjet e komisionit, kanë qenë të njoftuar me për vizitat e kryetares dhe aktivitetet tjera dhe besoj se

Albana Fetoshi, theksoi se nuk është e vërtetë që nuk ka qenë mbledhjet e komisionit dhe nuk është korrekte të thuhet se po leni përshtypje sikur nuk keni qenë në mbledhje dhe prandaj nuk jeni të informuara.

Kryetarja, theksoi se nëse keni ndonjë vërejtje për ndonjë çështje që është paraqitur këtu për të cilën mendoni se nuk kam raportuar në komision, ju lutem tregoni

Albana Fetoshi, rasti i shqyrtimit të Projektligjit për veteranet e luftës, keni pasur disa takime dhe keni dalaur me disa amandamente të formulaur dhe i keni qitur në votim që ne nuk kemi pasur kohë të mjaftueshme ti lexojmë. Për këtë qeshje keni pasur takime edhe me përfaqësues e FMN-së dhe nuk keni raportuar në komision.

Kryetarja, sa i përket projektligjit për veteranët e luftës, unë kam marru pjesë në një takim në të cilin kanë qenë të ftuar insitucionet relevante të organiazuar në Ministrinë e Financave dhe për këtë takim kam raportuar në komision. Amendamentet janë propozuar nga FMN dhe për këto ndryshime janë njoftuar anëtarët e komisionit. Materiale me amendamentet ka qenë në dispozicion të të gjithë anëtarëve të komisionit dhe të njëjtat amendamente janë diskutuar dhe votuar në mbledhjen e komisionit, në të cilën mbledhje nuk kam marrur pjesë për shkaqe familjare.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash nxori këtë

VENDIM

Miratohet raporti punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për periudhën mars-dhjetor 2011

9. Caktimi i grupit punues për Projektligjin nr.04/L-80 për Lojërat e Fatit

Kryetarja, projektligji për lojërat e fatit ka kaluar në lexim të parë dhe është një projektligj shumë i rëndësishëm për fushën që rregullon dhe shumë gjëra mund ti fusim në sistem me miratimin sa më të mirë të ligjit. Për këtë projektligji kemi biseduar me GIZ, për mundësinë e angazhimit e një eksperti nga vendet e Evropës perëndimore që e njeh mirë këtë fushë. Në këtë drejtim Projekti i GIZ ka punuar dhe ka rënë në kontakt me një ekspertë gjerman që vlerësohet se e njeh shumë këtë fushë. Për më tepër sqarime ia dha fjalën Ramadan Islami – koordinator i projektit të GIZ-it.

Ramadani Islami, njoftoi se sipas kërkesës së komisioni, kemi identifikuar një ekspertë shumë të mirë në Gjermani, që është profesor universiteti i specializuar në këtë fushë dhe anëtarë i disa forumeve hulumtuese. Eksperti ka analizuar draftin dhe shumë shpejt do ti dërgojë komentet, ndërsa personalisht

do të vie në Kosovë më 31 janar deri më 1 shkurt dhe do të jetë në dispozicion të komisionit për këtë çështje.

Pas propozimeve, komisioni caktoi grupin punues për shqyrtimin e projektligjit për lojërat e fatit në këtë përbërje: Hykmete Bajrami (raportuese), Latif Gashi, Albana Fetoshi dhe Duda Balje.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe me Raportin me amendamentet të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja, vlerësoi se kostoja buxhetore e projektligjit është e përballeshme për buxhetin e Kosovës.

Albana Fetoshi, pyeti sa është kostoja buxhetore e projektligjit, pasi që nuk ka pasur rast të shikojë?

Kryetarja, theksoi se më vjen keq që nuk e keni analizuar projektligjin dhe amendamentet, për të cilin jeni njoftuar përmes emali-it dhe iu është shpërndarë më kohë materiali. Kostoja buxhetore është vlerësuar të jetë 10.000-20.000€ dhe si e tillë është e përballeshme për buxhetin e Kosovës. Ju kisha sugjeruar të mos vazhdoni si vitin e kaluar por të angazhoheni më shumë.

Albana Fetoshi, theksoi se i ka shpëtuar ky lëshim për të shikuar koston financiare dhe nuk është jashtë normales të pyes, pasi që ka pasur raste edhe anëtarët tjerë që kanë pyetur. Megjithatë kostoja buxhetore e vlerësuar prej 1.0000-2.0000€ nuk qenka edhe aq e vogël. Mirëpo duke pasur parasysh natyrën e projektligjit që del nga Pakoja e Ahtisarit dhe interesimin e juaj që të kaloni sa më shpejtët, edhe po të ishte kostoja më e lartë

Komisioni me pesë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi dhe Duda Balje), tri Abstenime (Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami dhe Xhevdet Neziraj) dhe një Kundër (Alban Fetoshi) njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Projektligji nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, përmban implikime buxhetore të përballeshme për buxhetin e Kosovës.
- II. Amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

11. Të ndryshme.

Kryetarja, njoftoi me dy ekspertet nga GIZ, që kanë ardhur për të bërë një evaluim të projektit të GIZ-it për tri vitet e kaluara dhe parashikimet për objektivat e përbashkëta të Komisionit me GIZ-in në tri vitet e ardhshme. Është planifikuar që më 19.01.2012 në ndërtesën e GIZ-it të mbahet një takim i përbashkët me ekspertet, përfaqësuesit e projektit të GIZ dhe anëtarëve të Komisionit për të biseduar rreth projektit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj